



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të paragrafit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 63 paragrafi 63.1.3 pika (a) lidhur me paragrafin 63.1.2 të Rregullores 01/2022 për Prokurimit Publik lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 31.07.2023 të paraqitur nga Grupi i Operatorëve Ekonomik “LIMIT L&B” SH.P.K. & REHA EPOKSID SH.P.K. nga Prizreni, bie këtë :

VENDIM

I

Refuzohet **si e pa bazuar** kërkesa për rishqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik “LIMIT L&B” SH.P.K. & REHA EPOKSID SH.P.K. nga Prizreni e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 31.07.2023 për aktivitetin e prokurimit me numër: 626-23-5792-5-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-23-013-5-2-1 me titull: “Shtruarja e dyshemesë me epoksid dhe ndërtimi i kartotekës në objektin e ri të QKMF-s në KK Mamushë”

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Grupi i operatorëve ekonomik “LIMIT L&B” SH.P.K. & REHA EPOKSID SH.P.K. nga Prizreni me datë 31.07.2023 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: “Shtruarja e dyshemesë me epoksid dhe ndërtimi i kartotekës në objektin e ri të QKMF-s në KK Mamushë”

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1; 6; 7; 56; 59; 60 dhe 69 të LPP-s. Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-s, janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim:

Në pretendimin e parë të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim nga ana e grupit të operatorëve ekonomik ankues, është cekur se arsyet e eliminimit janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara dhe janë në kundërshtim të plotë me faktet dhe dëshmitë e ofruara nga grupi i O.E. ankues.

Ne shqyrtuam edhe njëherë dhe ekzaminuam sigurimin e tenderit të grupit të O.E. ankues dhe konstatuam që sigurimi i tenderit ka filluar me datën 03.07.2023 dhe ka pasur vlefshmëri deri me datën 30.09.2023 dhe pas kalkulimit na del se afati i sigurimit është tetëdhjetë e nëntë (89) ditë dhe jo nëntëdhjetë (90) sikur është kërkuar në dosje të tenderit, pra pretendimi është i pa bazuar.

Gjithashtu sigurimin e grupit të O.E. ankues e krahasuam edhe me sigurimet e paraqitura nga pjesëmarrësit tjerë në procedurën në fjalë dhe konstatuam që të gjithë O.E. tjerë pjesëmarrës, pra katër (4) prej tyre kanë dhënë afatin e sigurimit prej nëntëdhjetë (90) ditëve pra nga data 03.07.2023 deri me datën 01.10.2023

Më poshtë gjeni kalkulimin e afatit të sigurimit me anë të kalkulatorit:

 Calculator

Date calculation

Difference between dates 

From

July 3, 2023 

To

September 30, 2023 

Difference

2 months, 3 weeks, 6 days

89 days

Më tej grupi i O.E. ankues pretendon se kemi rekomanduar për kontratë një OE të pa përgjegjshëm me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar disa dëshmi për disa projekte të realizuara por që nuk kanë të bëjnë me natyrën e kontratës ose punë të ngjashme. Grupi i O.E. ankues më tej thekson se në listën e projekteve të realizuar nga OE i rekomanduar për kontratë vërehet se nuk ka përfunduar asnjë projekt me “Shtruarje e dyshemesë me epoksid” dhe kjo e bënë të qartë faktin se ky OE nuk ka punuar asnjëherë një punë të tillë. Më tej pretendon se autoriteti kontraktues ka kërkuar saktësisht bazuar edhe në titullin e kontratës që punimi kryesor duhet të jete me Epoksid, dhe pretendon që OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar asnjë dëshmi që ka punuar me këtë material të dyshemesë. Dhe duke u bazuar në këtë fakt pretendon që vërehet qartë dhe dëshmohet se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotësin kërkesën e lartcekur dhe se nuk e

përbush ne tërësi kërkesat e FDT-se dhe dosjes së tenderit dhe si i tillë duhet të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit sepse është OE i pa përgjegjshëm.

Ne shqyrtuam pretendimin e lartcekur të grupit të O.E. ankues dhe kontrolluam edhe njëherë ofertën e O.E. të rekomanduar për kontratë dhe vërejtëm që “Eko Term” SH.P.K. ka dorëzuar listën e projekteve të realizuara në tri vitet e fundit si dhe dëshmitë për realizimin e tyre për **punë të ngjashme** në vlerë prej **110,800.67 €**.

Duhet të theksojmë që nuk është i vërtetë pretendimi që titulli i kontratës është vetëm “Shtruarja e dyshemesë me epoksid” sikur e ka shkëputur një pjesë të titullit grupi i O.E. ankues por që titulli është: **“Shtruarja e dyshemesë me epoksid dhe ndërtimi i kartotekës në objektin e ri të QKMF-s në KK Mamushë”**

Pra kontrata nuk ka të bëjë vetëm me shtruarjen me epoksid por ka edhe punë tjera sikur është ndërtimi i kartotekës në të cilën janë paraqitur pozicionet të cilat janë të ngjashme me natyrën e punëve që i ka realizuar dhe i ka paraqitur O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës.

Gjithashtu duhet të sqarojmë që ne si AK në kërkesën tonë, nuk kemi paraqitur kërkesën që O.E. pjesëmarrës duhet të kenë realizuar kontrata për punë të **“njëta”** sikur pretendon grupi i O.E. ankues, por kërkesa është e qartë sikur e ka cekur edhe vetë grupi i O.E. ankues në kërkesën për rishqyrtim të vendimit se O.E. pjesëmarrës duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses **kontrata për punë të ngjashme** gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, së paku 45,000.00€. Andaj duke u bazuar në atë që u tha më lartë, vlerësojmë që edhe ky pretendim i grupit të O.E. ankues është i pa bazë dhe se O.E. i rekomanduar i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, si dhe ka dhënë çmimin më të ulët në mesin e tenderuesve pjesëmarrës të përgjegjshëm.

Më tej O.E. ankues pretendon që janë shkelur edhe dispozitat e nenit 59 të LPP-s për shkak që sipas O.E. ankues, është rekomanduar për dhënie një O.E. i pa përgjegjshëm me arsyetimin që nuk ka ofruar dëshmi për realizimin e kontratave të ngjashme sikur kemi sqaruar më lartë.

Pra pretendimi që është shkelur neni 59 i LPP-s është i pa bazë pasi që komisioni i vlerësimit gjatë vlerësimit të tenderit i ka respektuar me përpikëri të gjitha dispozitat e këtij neni.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së, konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë pasi që ne të gjithë pjesëmarrësit i kemi trajtuar në mënyrë të barabartë pa kurrfarë diskriminimi dhe procedurën e hapur për prokurimin në fjalë e kemi udhëhequr në mënyrë transparente në përputhje të plotë me legjislacionin e prokurimit në fuqi. O.E. ankues ka kërkuar qasje në dokumentet e tenderit në fjalë dhe ne kemi qenë transparent duke ia ofruar qasjen e pa penguar dhe në kohën më të shpejtë të mundur, për të gjitha dokumentet të cilat i ka kërkuar në përjashtim të dokumenteve për të cilat O.E. kanë bërë kërkesë për sekret afarist. Nga procesverbali i qasjes në dokumentacionin e këtij tenderi shihet se përfaqësuesi i O.E. ankues z. Liman Asllani nuk ka pasur asnjë vërejtje në lidhje me qasjen, gjithashtu të gjitha dokumentet e procedurës janë ngarkuar në platformën e-prokurimi dhe në ueb-faqe të Komunës së Mamushës, andaj është për tu habitur pretendimi i O.E. ankues se procedura nuk është zhvilluar në mënyrë transparente!

Aktiviteti i prokurimit është udhëhequr në përshtatje të plotë me dispozitat e nenit 4 paragrafi 4.3 të Rregullores për prokurimin publik 001/2022 të cilat parashohin:

Citat: “Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

- a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive.
- b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues.
- c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmangët çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.
- d. Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit.
- e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.
- f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.
- g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.”

Sikur shihet në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga ana e O.E. ankues, i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi apo fakt të vetëm i cili do të dëshmonte shkelje të dispozitave të lartcekura, andaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

Operatori Ekonomik ankues ka pretenduar se janë shkelur edhe dispozitat e nenit 1 dhe 6 të LPP-së. Edhe ky pretendim është i pa qëndrueshëm, pasi që ne si Autoritet Kontraktues i kemi respektuar të gjitha dispozitat ligjore të legjislacionit të Prokurimit Publik, për tu siguruar që kjo procedurë të zhvillohet në mënyrën më efikase dhe më ekonomike. Gjithashtu gjatë kësaj procedure, janë zbatuar të gjitha parimet e LPP-s dhe është marrë për bazë parimi i shfrytëzimit të drejtë të fondeve publike, duke u kujdesur që të marrim vlerën për paranë, pasi që kemi rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët sikur është paracaktuar kushti për dhënie të kontratës i cili ka qenë “tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët” i paraparë në dispozitat e nenit 60 paragrafi 1 pika 1.1. Pra qëllimi i LPP-s është që të mbrohet buxheti i shtetit duke siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Republikën e Kosovës. Andaj na del se ne si AK nuk i kemi shkelur dispozitat e neneve 1; 6; dhe 60 të LPP-s por i kemi respektuar me përpikëri dispozitat në fjalë. Ndërsa O.E. ankues ka ofruar çmimin më të lartë se O.E. i rekomanduar për kontratë si dhe ka dorëzuar tender të pa përgjegjshëm pasi që nuk e ka dhënë afatin e sigurimit të tenderit për nëntëdhjetë (90) ditë, është për tu habitur pretendimi se janë shkelur këto dispozita, por shihet qartë që këto pretendime janë paraqitur pa kurrfarë fakti apo prove.


Grupi i O.E. ankues në mënyrë paushalle pa dhënë kurrfarë sqarimi, ka cekur se janë shkelur edhe dispozitat e neneve 56 dhe 69 por që në kërkesën për rishqyrtim si dhe në pretendimet e tyre nuk kanë ofruar kurrfarë prove apo fakti për të dëshmuar se janë shkelur këto dispozita. Andaj konsiderojmë që edhe pretendimi që janë shkelur këto dispozita është i pa bazë.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 02.08.2023

Gazmend Gashi
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit
Komuna e Mamushës



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.